



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli i “Banca Intesa Akcionarsko Drustvo Beograd/Procredit Bank AD Beograd”

Pranë Autoritetit të Konkurrencës (AK) janë depozituar dokumente dhe informacione në lidhje me Marrëveshjen Kuadër për Shitblerjen e Portofolit të Kredive midis Procredit Bank AD Beograd dhe Banca Intesa AD Beograd.

Në datë 22.11.2017, palët Banca Intesa AD Beograd dhe Procredit Bank AD Beograd kanë nënshkruar Marrëveshjen Kuadër për Shitblerjen e Portofolit të Kredive. Banka Intesa SRB ofron shërbime bankare tek personat fizikë, ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha dhe klientët e korporatës në Serbi. Banca Intesa SRB është një filial i zotëruar plotësisht i Intesa Sanpaolo SpA Itali. Kjo e fundit është shoqëria mëmë e Intesa Sanpaolo Group, i cili është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet filialit në pronësi të plotë të tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Blerësi: Banca Intesa Akcionarsko Drustvo Beograd, (Intesa AD) një bankë e themeluar dhe që vepron sipas Ligjit të Serbisë, si shoqëri aksionare me seli të regjistruar në Milenta Popovica 7b, 11000 Belgrade, Serbi, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Serbe. Kjo bankë është themeluar në 15 tetor 1991.

Shitësi/Ndërmarrja Target: Procredit Bank AD Beograd, një bankë e themeluar dhe që vepron sipas Ligjit të Serbisë si shoqëri aksionare me seli të regjistruar në Milutina Milankovica 17, 11000 Belgrade, Serbi, e regjistruar në regjistrin e Shoqërive e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve Serbe.

Përqendrimi ka të bëjë me një transaksion financiar që realizon blerjen nga Banka Intesa SRB :

1. Të portofolit të përzgjedhur të kredisë së Procredit SRB dhe
2. Të bazës së përzgjedhur të klientëve të Procredit SRB.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b, dhe nenin 12, pika 1 dhe 2 , të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al